
ARCHIVAL POST

The "Coup" at the "Enver Hoxha" United School – A Moment of Political and Student Tension in 1991



Mod. 7

Emërtimi i institucionit Drejtoria I
Emërtimi i sektorit Drejtoria

DEKLASIFIKUAR

DOSJE Nr. 94 Viti 1991

TITULLI I DOSJES

Për disa probleme shqetësuese në Shkollën e Lartë të Bashkuar « Enver Hoxha ».

AIDSSH


Afati i ruajtjes i përhershëm
Faqe e fletëve 15
77
42

Ka filluar më 12.1.1991
Ka mbaruar më 4.3.1991
Regjistruar në inventarin e dosjeve
me numër rendor

SECTION	PERIOD
1970–1991	1991 - 1991

Media 1

MEDIA ITEMS #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA I
Nr. 5183

Sekret
Ekzemplar nr. 2

Tiranë, më 12. 1. 1991.

L ë n d a : Për disa probleme shqetësuese në Shkollën e Lartë të Bashkuar "Enver Hoxha".

MINISTRIT TË MBROJTJES POPULLORE
SHOKUT KIÇO MUSTAQI
TIRANË

Më datën 9.1.1991, u komunikua urdhëri i ministrit të Mbrojtjes Popullore, për ndërprerjen e studimeve me motivacion "Për thyerje disiplinore", studentëve të togës së III-të të Zbulimit dhe të një toge të vitit të IV-t, të Prapavijës.


Ky urdhër është dhënë mbi bazën e veprimeve negative që kanë kryer studentët e Zbulimit më datën 10.12.1990, kur ata u urdhëruan për të vendosur qetësinë në Qytetin "Studenti", por kundërshtuan duke bërtitur, se "jemi me studentët" e ngritën grushtet lart. Ndërsa studentët e Prapavijës kanë ikur pa leje nga shkolla dhe kanë marrë pjesë në mitingun e organizuar për legalizimin e Partisë Demokratike.

Urdhëri i ministrit të Mbrojtjes Popullore nuk është mirëpritur nga këta studentë dhe disa kuadro të shkollës. Këta të fundit janë shprehur, se "do të vijnë shqetësime të mëdha, pasi studentët do të hidhen në kërkesa të tjera".

Studentët e përjashtuar janë shprehur, se "po nuk e anullojnë urdhërin, do të bëjmë përvetë tërë studentët e shkollës për t'u ngritur në grevë të përgjithshme.

AIDOSH

MEDIA ITEMS #2



2.

Më datën 9.1.1991, në territorin e shkollës janë gjetur tre fletushka anonime, në të cilat bëhej thirrje, që "studentët të mos shkojnë në mësim".

Theksojmë, se studentë të veçantë, lidhur me futjen e gazetës "Rilindja Demokratike" në shkollë shprehen, se "po të mos lejohet futja e saj, studentët nuk do të marrin pjesë në zgjedhjet e 10 shkurtit".

Problemet e sipërme i janë bërë të njohura Komandës së Shkollës.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
HEKURAN ISAI

AIDOSH

INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

Media 2

MEDIA ITEMS #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA I
Nr. 1211

Sekret
Ekzemplar nr...4...
Tiranë, më 22. 2. 1991.

L ë n d a : Për disa probleme në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerave "Enver Hoxha" dhe Akademisë Ushtarake.


SHOKUT: RAMIZ, ADIL DHE KIÇO

Siç informohemi, studentët e Shkollës së Bashkuar të Oficerave "Enver Hoxha" dhe akademistët,kanë përpiluar një thirrje me kërkesa politike, ku parashtrojnë që : Deri në orën 16.00, datë 22.2.1991, kërkojnë që atje të shkojnë përfaqësues të Partive Politike e nga Radio-Televizioni, për të dialoguar për ngjarjet e ndodhura ditët e fundit në Tiranë dhe për figurën e Themelusit të Partisë; kanë shprehur shqetësim të madh për mosmbrojtjen e përmendoreve të shokut Enver, kush e ka përgjegjësinë për këtë dhe ç'masa do të merren. Kërkojnë të rivendoset përmendorja atje ku ka qenë.

Janë shprehur,"se në qoftë se deri në orën 16.00 nuk do t'u jepet përgjigje për thirrjen e bërë, do të sulmojnë me armë Radio-Televizionin, do të shkojnë në Muzeun Kombëtar të marrin përmendoren e Enver Hoxhës, të cilën do ta vendosin në vendin ku ka qenë, në pamundësi të kësaj,përmendoren që kanë në territorin e shkollës do ta vendosin mbi tank, të shoqëruar me studentët e ta vendosin në qendër

AIDSSH

MEDIA ITEMS #2



2.

të Tiranës, duke marrë dhe masa të përhershme për mbrojtjen e tij".

Del se studentët janë shumë të irituar dhe shprehen se tradhëtia është nga lart, duke vënë në pikëpyetje edhe vetë Presidentin dhe po qe se ky i fundit ka urdhëruar të mbrohen përmendoret, ai që nuk ka zbatuar urdhërin të shkoj në litar.

Shprehin gjithashtu shqetësimin për faktin, që Policia nuk mban armë, për atë që nuk është thirrur në ndihmë shkolla e tyre dhe se këtej e tutje nuk do të zbatojmë asnjë urdhër përveç atyre të Komandës së Akademisë e të shkollës.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
HEKURAN ISAI

AIDSSH

INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

Media 3

MEDIA ITEMS #1



(94)

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA I
Nr. 1309

Sekret
Ekzemplar nr. 1
Tiranë, më 4. 3. 1991.

L ë n d a : Për disa probleme në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerave "Enver Hoxha".

MINISTRIT TË MBROJTJES POPULLORE
SHOKUT KIÇO MUSTAQI
TIRANË

Siç informon Dega e Sigurimit të Shkollave Ushtarake, lidhur me ngjarjet e datave 22 e 23.2.1991, del se :


I[redacted], pedagog në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" ka strehuar në shtëpinë e tij katër nga elementët destruktiv, për çka është marrë një denoncim dhe më 23.2.1991 është shprehur : "Veprimi i shkollave ushtarake nuk është i drejtë, është vëllavrasës e sjell përçarje në popull".

Sipas një të dhëne të paverifikuar, rezulton se studentët I[redacted], i Ndërlidhjes, S[redacted] e I[redacted], të Transportit, janë shprehur se : "Nuk jemi dakort me këtë qëndrim të studentëve, bëmë gabim dhe historia do të na dënojë. Ne nuk kemi pse të kërkojmë të vendoset shtatorja e Enver Hoxhës... tani duhet të ruhemi, se do të na kërcënojnë e do na vrasin".

Oficer '[redacted], pedagog i Taktikës, sipas një të dhëne të paverifikuar, u ka thënë dy oficerave : "Veprimi dhe solidariteti i studentëve të shkollave ushtarake ishte skenar i përgatitur. Shkolla u përdor si karem për të mbuluar atë gjendje që ekziston në

AIDSSH

MEDIA ITEMS #2



(95)

2.

vendin tonë. U inskenua sikur do të hiqej busti i Enver Hoxhës dhe ky inskenim u bë për të justifikuar armatosjen e studentëve e për t'i irituar që të manifestojnë".

Pjesa më e madhe e akademistëve të vitit të dytë gjitharmësh, më datën 26.2.1991 nuk kanë pranuar të shkonin në mësim dhe të irituar thonin : "Pse nuk po na plotësohen kërkesat që u publikuan, përse nuk del ligji për mbrojtjen e ushtarakut, pasi na kërcënojnë rrugëve, nga familjet na dërgohen telegrame e nuk na vijnë...". Një shqetësim të tillë e kanë shfaqur edhe disa studentë, të cilët shprehen, se:"Na është krijuar ambient i vështirë rreth shkollave, nuk na pranojnë nëpër dyqane, nuk na shërbejnë në postë", etj.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
RAMIZ ÇUÇI

AIDSSH

INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

Media 4

MEDIA ITEMS #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA I
Nr. 1155

Sekret
Ekzemplar nr....1..
Tiranë, më 20.2. 1991.


L ë n d a : Për disa komente në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerave "Enver Hoxha".

KRYETARIT TË PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR
SHOKUT RAMIZ ALIA
TIRANË

Dega e Sigurimit të Shkollave Ushtarake informon se sipas dy denoncuesve del se oficer S , pedagog i historisë s hkodër, është shprehur : "Për Partinë e Punës nuk ka më fitore, apo edhe këtë legjislaturë ka jetë... këtij pushteti i erdhi fundi e duhet të përmbyset...".

Studenti , i vitit të dytë në kufi, në prani të gjithë studentëve të klasës ka thënë : "... Jam në komisionin nismëtar për organizimin e shoqatës të studentëve ushtarak. Do të mblidhemi në fushën e sportit, ku do të flasin organizatorët e kësaj shoqate, prandaj dilni të gjithë. Kërkesat tona janë : Përmirësimi i kushteve të jetesës e ushqimit, të shkrihet Komiteti i Partisë së Shkollave e godina t'u jepet studentëve; Akademia Ushtarake të largohet dhe godinat t'u jepen studentëve; të anullohet urdhëri i ministrit të Mbrojtjes Popullore për përjashtimin e studentëve që plotësojnë 12 mungesa; tani për tani nuk jemi për heqjen e emrit të shkollës, se po e kërkuam këtë do të kemi përfundim të keq, këtë do ta bëjmë më vonë. N Ll i e thonë se duhet të kërkojmë edhe heqjen e emrit të shkollës. Të tre këta studentë më datën 11.2.1991, duke ngrënë boçe pishe, kanë qëlluar disa herë portretin e Themeluesit të Par-

MEDIA ITEMS #2



2.

tisë." Theksojmë, se në klasën e vitit të dytë të kufirit, më datën 13.2.1991, rreth orës 16.30 është hequr portreti i Themeluesit të Partisë dhe nuk dihet se ku është çuar.

Për problemet e sipërme është informuar edhe Komanda e Kufirit.

Studenti I i vitit të katërt të artilerisë ka filluar të shpërndajë lista të marra nga komisioni nismëtar i Partisë Demokratike për të rregjistruar studentë ushtarakë në shoqatën e tyre.

Sipas denoncimit të oficer I , pedagog në Hepar- 'au i Dejës, del se kursanti , i ka thënë : "... Unë jam kundër PPSH dhe kam aftësi të bëj edhe 100 kursantë të votojnë kundër saj, po ti pedagog më cilën Parti je". Unë, - thotë i thashë; "se po ma shave PPSH ta numëroj në lule të ballit." i thotë : "Mos u nxito se edhe unë kam automatik dhe të zhduk".

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
HEKURAN ISAI

AIDSH

INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

Media 5

MEDIA ITEMS #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE SHQIPËRISË "S e k r e t e"
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME Ekzemplar Nr 1
DEGA SIG REP USHT I460
Nr 20 Prot Tiranë më 9.4. 1991

INFORMACION

PËR DISA PROBLEME NË SHKOLLËN E LARTË TË OFICERAVE TË FLD "HYSNI KAPO"

Sipas porosisë së dhënë nga Drejtusit e DSU lidhur me disa të dhëna që kanë dalë në këtë shkollë,ju informojmë si më poshtë:


1.Gjatë periudhës së tremujorit të parë 1991 nga Shkolla e Lartë e oficerave të FLD "Hysni Kapo " Vlorë janë larguar duke realizuar kalimin e pa ligjshëm të kufirit këta studentë ushtarakë: [redacted] nga Durrësi v[redacted],larguar në Janar 1991 nga kufiri grek në kohën që kryente praktikën në repartin ushtarak 4220 Himarë, I[redacted] nga Durrësi,viti i tretë,dega peshkim,larguar në Shkurt për Itali me anijen "Fatosi" që u rrëmbye në atë kohë, [redacted] nga Vlora,viti i parë dega peshkim,larguar për Itali me anije peshkimi.

Gjithashtu sipas denoncimit të pa verifikuar rezulton se edhe disa studentë të tjerë të degës peshkim që kanë disa muaj që po kryejnë praktikën në peshkim duhet të jenë larguar jashtë shtetit siç janë: [redacted],por kjo e dhënë do të saktësohet me përfundimin e praktikës se ata janë të shpërndarë gjithandej në peshkim.Theksojmë se kjo praktikë nuk ka shërbyer fare sepse siç dihet shumica e anijeve të peshkimit kanë qënë të bllokuara, kështu që studentët më shumë kanë qëndruar pranë familjeve.

2.Në këtë shkollë prej kohësh ka qënë shqetësuese gjëndja aspak e mirë e disiplinës ushtarake,çështje të cilën ne e kemi ngritur disa herë qysh në vitet e kaluara,por nuk është mbajtur ndonjë qëndrim.Veç atyre që janë larguar ka dhe studentë që nuk duan të vazhdojnë mësimet, siç janë: [redacted] të dy të vitit katërt,dega luftarake të cilët nuk duan të vazhdojnë mësimet,kanë bërë shumë mungesa,madje disa nga këta shpreheh se me atë trajtim të ulët që ka oficeri,nuk ka as një

ARCHIVE
AIDSSH

MEDIA ITEMS #2



- 2 -

interes për të qëndruar në këtë shkollë,madje kanë shprehur edhe mendime për ndryshimin e emërtimit të profesionit në Diplomë,që të quhen navigator,synimi është i qartë për të kaluar në flotë tregëtare ose për tu punësuar jashtë shtetit.

- Nga [redacted] e [redacted] të vitit katërt,pati edhe tendence për peticion ku midis të tjerave kërkohej heqja e emrit të kësaj shkolle,por me ndërhyrjen e komandës nuk u lejua.

- Po kështu nga studentët ka shumë ikje pa leje në qytet ose dalkin me uniformë të çrregullt,pa kapele e tjera,çështje këto që janë biseduar shpesh herë me komandën e shkollës,ditët e fundit ka një far ndryshimi në kuptimin pozitiv.

3.Sipas sinjalizimeve të bp Rudolfi del që negativisht influencojnë për disa çështje të rregullit e disiplinës edhe qëndrimet liberale të disa kuadrove siç janë [redacted] e [redacted] madje këta të dy dhe [redacted] kanë dorzuar teserat dhe dy të parët kerkojnë me këmbëngulje të largohen në flotë tregëtare,bile edhe dipllomat i kanë rregulluar me titullin navigator e tjera.

Të gjitha këto çështje i kemi biseduar me komisarin e FLD-së.

Konc Dakt SH.B.
Kopje dy
Lidhje dy

Kryetari Degës Sig Rep Usht I460
Shefki Balliu

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.